


Tregtia e jashtme e mallrave

Korrik 2024

Tiranë, më 19 Gusht 2024: Në Korrik 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 33 mld lekë, duke u ulur me -12,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me -4,1 %, në krahasim me Qershor 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 85 mld lekë, duke u rritur me 21,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe 11,5 %, në krahasim me Qershor 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 52 mld lekë, duke u rritur me 59,6 %, krahasuar me Korrik 2023 dhe 24,3 %, në krahasim me Qershor 2024.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Në këtë shtatëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 233 mld lekë, duke u ulur me -14,5 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 526 mld lekë, duke u rritur me 3,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 293 mld lekë, duke u rritur me 23,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.


Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Korrik 2024, në uljen e eksporteve prej -12,0 %, kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -11,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,0 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me -0,7 pikë përqindje, etj. Pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,0 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,4 pikë përqindje, etj.

Për publikim 19/08/2024

Vijon


Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Korrik 2024



Eksportet, gjatë këtij shtatëmujori janë ulur me -14,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -6,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,2 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,2 pikë përqindje, etj. Pozitivisht ka ndikuar grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,1 pikë përqindje, etj.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Korrik 2024, në rritjen e importeve prej +21,1 %, krahasuar me Korrik 2023, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +6,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,4 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +3,0 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht ka ndikuar grupi: “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,3 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Korrik 2024

Si shtatëmujor, importet janë rritur me +3,2 %, krahasuar me shtatëmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,3 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,5 pikë përqindje, Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,6 pikë përqindje, etj. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,1 pikë përqindje, etj.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Korrik 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me Korrik 2023 janë: Italia (9,0 %), Spanja (53,4 %), Maqedonia e Veriut (8,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (9,8 %), Greqia (0,3 %), Gjermania (0,8 %), etj.

Gjatë këtij shtatëmujori vendi me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, është: Italia (14,1 %), Greqia (21,6 %), Gjermania (11,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kosova (0,1 %), Kina (25,7 %), etj.

Në muajin Korrik 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, janë: Italia (5,7 %), Kina (29,6 %), Turqia (19,9 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: SHBA (5,2 %), Spanja (8,3 %), Kroacia (13,0 %), etj.

Gjatë këtij shtatëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (17,1 %), Greqia (19,3 %), Gjermania (6,0 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet shtëkanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (2,9 %), Kina (3,7 %), Maqedonia e Veriut (9,4 %), etj.

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Korrik 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 56,9 %, të gjithë tregtisë. Në Korrik 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,1 %), Kina (9,2 %), Greqia (7,3 %) dhe Turqia (6,3 %).

Shkëmbimet tregtare, për shtatëmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 57,9 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Korrik 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,6 %), Turqia (8,2 %), Kina (7,7 %) dhe Greqia (7,3 %)

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Korrik 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	Janar – Korrik 21	209	39,2	426	29,8	-217	49,0
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	Janar – Korrik 22	293	40,1	528	23,9	-235	55,4
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	Janar – Korrik 23	272	-7,0	509	-3,5	-237	53,4
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	Janar – Korrik 24	233	-14,5	526	3,2	-293	44,2

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë). Korrik 2024

	Eksporte				Importe			
	Korrik 2023	Korrik 2024	Jan, - Korrik 2023	Jan, - Korrik 2024	Korrik 2023	Korrik 2024	Jan, - Korrik 2023	Jan, - Korrik 2024
Vendet e BE-së	27.339	23.928	200.910	166.289	38.273	43.709	263.753	272.886
Austri	170	149	2.357	1.551	770	857	4.407	4.577
Gjermani	1.923	1.938	14.810	13.052	5.251	6.312	35.472	37.614
Greqi	2.386	2.392	18.558	14.551	4.625	6.234	33.955	40.492
Itali	16.374	14.894	119.763	102.912	17.442	18.441	117.592	114.209
Spanjë	2.285	1.065	11.800	7.648	1.218	1.117	7.621	8.009
Kroaci	273	296	3.379	2.756	881	766	4.340	2.723
Të tjera të BE-së	3.928	3.194	30.242	23.819	8.086	9.982	60.366	65.261
Mbretëri e Bashkuar	2.574	155	3.426	938	629	1.146	4.850	5.975
Kinë	607	792	4.902	6.163	7.812	10.121	54.596	52.549
Kosovë	3.404	3.738	23.779	23.801	987	2.069	6.398	8.914
Maqedonia e Veriut	1.097	1.001	11.197	8.388	1.055	1.121	7.833	7.099
Rusi	-	-	8	5	243	530	2.825	2.172
SHBA	264	652	2.499	2.766	1.465	1.388	10.345	11.623
Turqi	233	347	2.454	2.478	5.964	7.151	50.878	59.577
Ukrainë	26	50	1.020	2.453	468	645	2.450	2.696
Zvicër	526	263	3.540	1.562	515	894	8.158	4.551
Të tjera	1.808	2.393	18.426	17.745	13.147	16.695	97.186	97.663
Gjithsej	37.877	33.320	272.163	232.589	70.558	85.471	509.272	525.705

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë). Korrik 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Korrik 2023	Korrik 2024	Jan, - Korrik 2023	Jan, - Korrik 2024	Korrik 2023	Korrik 2024	Jan, - Korrik 2023	Jan, - Korrik 2024
Gjithsej	37.877	33.320	272.163	232.589	70.558	85.471	509.272	525.705
Ushqime. pije. duhan	4.787	4.519	35.394	32.080	13.206	15.345	82.471	90.171
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	9.689	5.416	60.618	44.239	7.929	9.186	57.576	51.189
Produkte kimike dhe plastike	1.277	1.826	9.106	9.479	8.628	10.274	68.517	68.404
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	185	169	1.751	1.325	1.185	975	8.888	7.318
Prodhime druri dhe letre	879	949	6.848	5.971	2.330	3.079	17.661	17.821
Tekstile dhe këpucë	11.440	9.931	79.543	65.347	7.897	7.974	56.312	50.668
Materiale ndërtimi dhe metale	5.303	6.430	47.249	43.273	8.127	11.928	72.338	75.259
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	3.278	3.131	24.204	22.342	18.237	22.750	124.692	141.337
Të tjera	1.038	949	7.450	8.532	3.018	3.960	20.817	23.538

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Korrik 2024

	Itali		Kosovë		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	119.763	102.912	23.779	23.801	18.558	14.551	14.810	13.052
Ushqim. pije duhan	9.347	8.447	4.034	3.867	2.796	2.562	1.121	1.072
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	5.896	8.283	4.653	5.060	6.489	2.134	5.532	3.834
Produkte kimike dhe plastike	3.576	3.578	2.385	2.457	676	587	31	27
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.661	1.117	7	4	15	145	3	1
Prodhime druri dhe letre	4.091	3.231	667	691	1.089	956	75	68
Tekstile dhe këpucë	62.269	49.435	141	100	4.162	4.894	5.987	5.627
Materiale ndërtimi dhe metale	16.249	13.547	9.470	9.534	2.612	2.629	852	519
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	13.249	12.015	1.401	1.296	77	141	1.003	1.640
Të tjera	3.425	3.258	1.021	792	642	504	206	263

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Korrik 2024

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	117.592	114.209	50.878	59.577	54.596	52.549	33.955	40.492
Ushqim. pije duhan	16.139	18.227	3.541	3.223	1.118	1.017	10.159	11.197
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	3.948	3.251	7.188	7.745	28	14	3.482	6.161
Produkte kimike dhe plastike	14.519	13.993	6.993	7.178	4.617	4.331	5.860	6.837
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.266	5.700	192	207	470	572	21	118
Prodhime druri dhe letre	4.097	3.672	2.882	2.870	1.094	1.104	2.279	2.456
Tekstile dhe këpucë	26.840	22.018	8.478	6.732	7.019	7.834	3.238	3.956
Materiale ndërtimi dhe metale	15.838	13.716	11.938	16.956	7.525	7.192	5.346	5.581
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	23.894	26.886	7.338	12.103	28.713	25.889	2.394	2.689
Të tjera	5.052	6.745	2.329	2.563	4.010	4.595	1.176	1.498

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri